



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:268301  
Datë: 12.11.2020  
Numri i dokumentit: 01268176

A.nr.625/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditesit E. SHPK seli në V. kunder të paditures Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 11.11.2020, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET Kërkesëpadia e paditësit E. SHPK seli në V., si e pa bazuar.

Mbetet në fuqi Aktvendimi nr.01.3.2.2/77 datës 22.02.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosoves ne Prishtine ka refuzuar kërkesën e paditësit si të pabazuar për rishqyrtimin e vendimeve R272/08.01.2018, R461/10.01.2018, R686/12.01.2018, R782/13.01.2018, R848/15.01.2018, R1057/17.01.2018, R1165/18.01.2018, R1102/18.01.2018, R1248/19.01.2018, R1322/20.01.2018, R1309/20.01.2018, R1497/23.01.2018, R1586/24.01.2018, R1665/25.01.2018, R1847/27.01.2018, R1922/29.01.2018, R2133/31.01.2018, R2113/31.01.2018, R2226/01.02.2018, R2308/02.02.2018, R2394/03.02.2018, të ZBD Prizren.

Paditësi E. SHPK seli në V., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 05.04.2018, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosoves në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, të anulohet aktvendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr. 01.3.2.2/77 datës 22.02.2018, dhe të detyrohet e paditura që të bëjë kthimin e mjeteve të paguara më emër të detyrimeve të importit të paguara më tepër mbi vlerën e transaksionit.

Paditësi në padinë e tij dhe përmes të autorizuarit në seancën publike deklaroi: mbetem në tërësi si në të theksuarat në padi, duke konsideruar se e paditura ka bërë shkeljet ligjore të referuara në padi, përkatësisht nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave, lidhur me nenin 123 të U.A. nr.11/2009, pasi që paditësi me rastin e paraqitjes së mallit, për zhdoganim me anë të DUD-ve kontestues, e po ashtu edhe në procedurën e ankesës, i ka bashkangjitur lëndës dokumente relevante për të vërtetuar çmimin e transaksionit, sikurse janë, faturat, kontrata e furnizimit, prandaj çmimi i tyre ka mund të verifikohet përmes bashkëpunimit me Doganën e shtetit

eksportues dhe konsiderojmë se do të duhej të merret për bazë sasia e mallrave të kontraktuara dhe faktin se paditësi është importues i rregullt i këtyre llojeve të mallrave. Dogana e Kosovës në këtë rast nuk është dashur të kalojë ne metodat tjera të vlerësimit të mallrave pa kaluar nëpër metodat paraprake dhe pa ia arsyetuar veç e veç, pasi që një vlerësim i tillë është në kundërshtim me metodat e vlerësimit sipas dispozitave të nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave. Duke pasur parasysh të theksuarat, edhe provat e administruara i propozoj gjykatës që të aprovoj kërkesëpadinë si të bazuar, ashtu që të anuloi Aktvendimin e atakuar dhe lëndën ta kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

E paditura në përgjigje në padi dt.25.01.2020 dhe përmes të autorizuarit në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar: e kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, dhe i propozojmë gjykatës që të njëjtën ta refuzoi si të pa bazë duke lënë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm dhe të drejtë, pasi që i njëjti është marrë konform dispozitave ligjore në fuqi. Po ashtu Dogana e Kosovës konsideron se në këtë rast është vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit i është referuar metodës së tretë të rivlerësimit, sipas nenit 34.2 pika (b), duke u bazuar në mallrat e ngjashme, e po ashtu kur është aplikuar metoda e gjashtë e vlerësimit përkatësishtë neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave, pasi që për mallin lëndor kontestues janë gjetur të dhëna në vlerë më të lartë se ajo e deklaruar. Gjithashtu potencojmë faktin se në Kontratën për furnizim me hekur ndërtimi të lidhur në mes të subjekteve afariste nuk flitet fare për çmimin, mirëpo i njëjti është i ndryshueshëm ashtu sikurse edhe e ka potencuar në nenin 2.2 të kësaj kontrate. Pra si i tillë ky çmim ndryshon sipas bursës, duke theksuar gjithashtu se këto ndryshime të çmimit do të përcillen blerësit me shkrim (imell, faks ose letër), të paktën një ditë përpara qdo lloji ndryshimi në çmim. Për më tepër siq shihet edhe në arsyetimin e aktvendimit kontestues, paditësi nuk ka arritur që të prezantoi dëshmi me të cilat do të vërtetonte, se për mallin përkatës ka realizuar transaksione bankare ashtu siq pretendon. Andaj në bazë të theksuarave si më sipër i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoi në tërësi si të pa bazuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 11.11.2020 administroi këto prova: përgjigja në padi e dt.25.01.2020 nga Dogana e Kosovës, aktvendimi nr.01.3.2.2/124, dt.16.03.2018 i Doganës së Kosovës, Kontrata për furnizim me hekur ndërtimi e dt.07.12.2017, ankesa e paditësit, Deklaratat Doganore, faturat e shitjes tatimore të dt.03.02.2018, dt.05.02.2018, 06.02.2018 dhe 07.02.20, Autorizimi NR.AL/08/200000/16 dt.14.07.2016, Autorizimi për procedurën e thjeshtëzuar, e dt.11.10.2017 nga Dogana e Kosovës, Kontrata e shitblerjes-Korimi International sh.a., Kontratë Pune nr.29/09 dt.02.03.2009, Specifikacionet– nr.04/03 dt.07.02.2018 dhe nr.05/10 dt.08.02.2018, Procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, Kontrata e Punës për Kohë të Caktuar/të pacaktuar e dt.01.12.2010, fatura e mallrave të lëshuara nën procedurën e thjeshtëzuar.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, vlerësoi ligjshmerinë e aktvendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues gjykata konstaton se e paditura ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është çmim real i paguar për mallin me qëllim të importit në vendin tonë. Sektori i inspektimit pas zhdoganimit dhe Sektori i pranimit qendror ka vepruar drejtë kur gjatë përcaktimit të vlerës së mallrave është bazuar në metodën e tretë dhe të gjashtë të vlerësimit konform nenit 34 par.2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht në bazë të të dhënave të transaksioneve të mallrave të

ngjashme. Vendimin e vet e paditura e ka mbështetur në të dhënat e sistemit ASYCUDA dhe COGNOS lidhur me importet identike dhe të ngjashme të mallrave të ngjashëm me mallin lëndor kontestues me kod të njëjtë tarifor, përshkrim të njëjtë të mallit lëndor nga shteti i njëjtë eksportues dhe i origjinës, mirëpo me vlerë më të lartë se vlera e mallit kontestues, DUD-at R178/05.01.2018, R213/06.01.2018, R312/08.01.2018, R505/08.01.2018, R537/08.01.2018..

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlerë e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr. 03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi që thekson se mallin lëndor e kanë përcjell të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat kërkohen konform nenit 123 të U.A. nr.11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vleresimit neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit-eksportuesit të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar gjykatës provat materiale si faturat e mallit, kontratën për furnizim, mirëpo nuk ka arrit të dëshmoj pagesën e mallit lëndor si dëshmi se është deklaruar vlera reale e mallit doganor, prandaj edhe gjykata i pranon konstatimet e cekura në arsyetimin e vendimit kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është provë e pamjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e paditësit se është paguar vlera reale e mallit lëndor. Gjykata nga provat e lëndës ka konstatuar se e paditura ka gjetur dëshmi në sistemin ASYCUDA dhe COGNOS lidhur me importet identike dhe të ngjashme të mallrave dhe ka konstatuar se në periudhë të afërt kohore është zhdoganuar malli i ngjashëm me mallin lëndor kontestues me kod të njëjtë tarifor, përshkrim të njëjtë të mallit lëndor nga shteti njëjtë eksportues dhe i origjinës, mirëpo me vlerë më të lartë se vlera e mallit kontestues. Paditësi nuk e ka kundërshtuar këtë transaksion të mallit të ngjashëm si provë vendimtare me të cilën është bërë rivlerësimi i mallit doganor konform nenit 34 par.2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi tjetër se për mallin e ngjashëm apo identik është pranuar vlera e transaksionit konform nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109.

Si fakte vendimtare që kanë ndikuar në rivlerësimin e mallit lëndor sipas nenit 34 paragrafi 2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës posedon mallra të ngjashme të zhdoganuara në periudhë të afërt kohore me mallin lëndor kontestues. Gjykata vlerëson se provat e tilla me të cilat është rivlerësuar malli lëndor sipas transaksioneve të ngjashme është provë e bazuar për të vlerësuar mallin lëndor sipas nenit 34 paragrafi 2 pika (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, prandaj gjykata konstaton se është aplikuar drejt dispozita ligjore kur është rivlerësuar malli lëndor sipas çmimit të mallrave të ngjashme.

Nga kjo gjendje gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja që e ka konstatuar e paditura në procedurën administrative, për arsye se nga pretendimet e fakteve të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, nuk janë paraqitur provat e nevojshme që do të dëshmonin vlerën e transaksionit të mallit lëndor.

Ne bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se aktvendimi 01.3.2.2/77 datës 22.02.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.1 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal  
A.nr.625/18 datë 11.11.2020

G j y q t a r i,  
Krenar Berisha

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njejtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.